

## NË EMER TE POPULLIT

**Gjykata Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Rënda,** duke vendosur sipas kryetarit te trupit gjykues Naser Maliqi, ne ceshtjen penale te te pandehurit A.D. nga f. ... K. ..., , per shkak te vepres penale mbajtje ne pronsi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 paragrafi 1 te KPRK-se, sipas aktakuzes se Prokurorise Themelore ne Gjilan, Departametni per Krimet e Renda, PP.I. nr. 66/18, e dt. 19.03.2018, e pas mbajtjes e shqyrtimit fillestar me dt. 26.04.2018, shpalle ndersa me 30.04.2018 perpilon:

## AKTGJYKIM

**Ndaj te pandehurit A.D.** nga bababi N. dhe nena S., e lindur M., i lindur me data e lindjes... ne ..., tani me vendbanim ne f. ... K. ..., ka ate kryer shkollen e mesme, me profesion mekanik, i gjendjes se varfer ekonomike, i martuar, pa femije, serbe, shtetas i Repubilkes se Kosoves.

## ËSHTE FAJTOR

Ne kohe te pa percaktuar me pare, i pandehuri pa autorizim dhe ne kundersiztim me ligjin e zbatueshem lidhur me armet, ka mbajtur ne pronsi arme te zjarra dhe ate; nji pushke gjysem automatike e kalibrit 7.66 mm, nji pushke gjuetie e kalibrit 12 mm, kater fisheke te kalibrit 7.62 mm, 32 fisheke te kalibrit 12 mm, 5 fisheke te kalibrit 16 mm, tri thika te medha,, nji thike e armeve luftarake, nji gasmaske, tre rrethatore per fisheke gjuetie, nji jeleke per mbajtje te municionit, paisje per pastrimin e armeve, ashtu qe me daten 08.03.2018 ne intervalin kohor prej 08;15 deri ne ora 09;20 ne shtepin e tij ne f. ..., K. ..., gjate bastisjes nga zyrtaret e ... ne ..., jan gjetur armet e lartecekura e te cilat jan konfiskuar.

-me c' raste ka kryer vepren penale, mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 paragrafi 1 te KPRK-se.

-Andaj, ne baze te nenit 4, 41,42,43,45,46,47 te KPRK, dhe nenit 233, 365 dhe 450 te KPPRK, se

## **E GJYKON**

**Me denim me burg ne kohezgjatje prej 120 ditesh,** i cili denim me kerkesen e te akzuarit i zavendsohet me denim me gjobe ne shume prej 1.300,00 (njimije e treqind) euro, te cilat duhet te paguhen ne afat prej 15 ditesh nga dita e plotfuqishmeris se ketij aktgjykimi.

**Detyrohet i pandehuri A.D.,** qe kesaj gjykate t'ia paguaj shumen prej 20 euro, ne emer te paushallit gjyqësor, si dhe shpenzimet e procedures penale sipas llogarise perfundimaterë, te gjitha keto ne afat prej 15 diteve nga dita e plotfuqishmersie se keti aktgjykimi.

**Konfiskohen** dhe ate; nji pushke gjysem automatike e kalibrit 7.66 mm, nji pushke gjuetie e kalibrit 12 mm, kater fisheke te kalibrit 7.62 mm, 32 fisheke te kalibrit 12 mm, 5 fisheke te kalibrit 16 mm, tri thika te medha,, nji thike e armeve luftarake, nji gasmaske, tre rrethatore per fisheke gjuetie, nji jeleke per mbajtje te municionit, paisje per pastrimin e armeve , konform nenit 374. paragrafi. 3 te KPRK-se.

## **A R S Y E T I M**

**Prokuroria Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Renda,** me dt. 19.03.2018 ka ngritur aktakuzen PP/I, nr.66/2018, ndaj te pandehurit A.D., per shkak te vepres penale mbajtja ne pronesi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 paragrafi 1 te KPRK-se dhe ka kerkuar qe pas mbajatjes se shqyrtimit gjyqësor, i njejt te shpallet fajtor dhe te denohet me denim meritor sipas ligjit.

Kryetari i trupit gjykues, me dt. 26.04.2018 ka mbajtur seancen fillestare, ne te cilen gjykates i eshte dorzuar nji marrveshje per pranimin e fajsise e lidhur ne mes te PTHK, te pandehurit A.D. dhe av. M.M.

Gjykata e ka aprovuar marveshjen per pranimin e fajsise, pas marrjes se mendimit nga prokurori i shtetit dhe nga mbrojtesi i te akuzuares dhe nga vet e akuzuara, per shkak se ky pranim eshte bere ne menyre

vullnetare, pa imponim dhe pa asnje presion, duke i ditur pasojat e pranimet te fajesise nga ana e te akuzuarit.

Gjate matjes dhe shqiptimit te denimit, Gjykata ka patur parasysh sjelljen e mire te te pandehurit ne Gjykate, pranimin e fajesise pa asnji hezitim, pendimin e tij per vepren e kryer, ka kerkuar falje, ndersa si rrethane renduese ka marre parasysh sasine e armeve.

Per kete arsye u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi, ku e akuzuara eshte shpallur fajtor dhe gjykuar me denim burgu ne kohezgatje prej 120 ditesh, dhe me kerkesen e te akuzuarit dhe mbrojtisit te tij, ky denim me burg i eshte zavendsuar me denim me gjobe ne shume prej 1300 euro.

Sa I perket armve; nji pushke gjysem automatike e kalibrit 7.66 mm, nji pushke gjuetie e kalibrit 12 mm, kater fisheke te kalibrit 7.62 mm, 32 fisheke te kalibrit 12 mm, 5 fisheke te kalibrit 16 mm, tri thika te medha,, nji thike e armeve luftarake, nji gasmaske, tre rrethatore per fisheke gjuetie, nji jeleke per mbajtje te municionit, paisje per pastrimin e armeve, te njejtat jan konfiskuar.

Gjykata te pandehurin e ka detyruar, qe kesaj Gjykate t' ia paguaj shumen paushalle prej 20 euro, ndersa shpenzimet e procedures sipas llogarise perfundimtare te kesaj Gjykate.

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN**  
**DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA**  
**Me dt, 30.04.2018**

**Sekretare Jurdike,**  
**Zahide Rexhepi**

**Kryetari i trupit:**  
**Naser Maliqi**

**KSHILLA JURIDIKE:** Kunder ketij aktgjykimi, palet e paknaqura munde te ushtrojne ankese ne afat prej 15 ditesh, nga dita e marrjes ne Gjykatën e Apelit te Kosoves ne Prishtine, e nepermes kesaj Gjykate.